



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:016793

Datë: 04.03.2022

Numri i dokumentit: 02776243

P.nr.162/22

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm Penal - gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.I. nga Prizreni me vendbanim në lagjen për shkak të veprës penale, kanosje nga neni 181. par.4. lidhur me para. 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 të (KPRK)-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 178-12/22 të datës 16.02.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Naim Gashi, të dëmtuarit, i akuzuari me mbrojtësin av. A.H. nga Prizreni , me datën 23.02.2022, mori dhe shpalli ndërsa përpiloj me datën 28.02.2022 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.I. nga i ati R. dhe e ëma V. e lindur K. i lindur me datë në Prizren, me vendbanim në lagjen kati i parë banesa nr.3, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, **shqiptar**, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

ËSHTË FAJTOR

Me datë 26.01.2022, rrethe orës 10:00 në Lagjën në Prizren, saktësisht në banesën e tyre të përbashkët familjare, me qëllim të frikësimit, e kanos seriozisht me fjalë se do ta privojë nga jeta të dëmtuarën V.K. konkretisht nënën e tij – viktimë e ndjeshme, në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje lidhur me kërkesën e tij të vazhdueshme që prindërit ti jepnin para, i pandehuri për një moment pasi e dëmtuara nuk pranoi ti jepte para, në gjendje të nervozuar i drejtohet me ton të lartë se “ unë po du pare, nëse nuk më jep pare atëherë keni me ma pa sherrin, kam me thye gjithçka që ka në banesë “ , e më pas në shenjë revolte ia merr telefonin e të dëmtuarës duke i thënë se do ta shesë

dhe largohet nga banesa, me ç 'rast me këtë veprim tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e saj personale.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale, kanosje nga neni 181. par.4. lidhur me para. 1. të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 41, 42, 46, 48, 49, 50, 51, 52, 69, 70, 71. 72. të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së.

Të akuzuarit M.I. i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton:

-Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti**, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, brenda periudhës së verifikimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

-E dëmtuara Valbona Krasniqi me adresë si në shkresat e lëndës për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.

-I akuzuari **obligohet** që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr. 178-12/22 të datës 16.02.2022, kundër të akuzuarit M.I. nga Prizreni me vendbanim në lagjen ... për shkak të veprës penale, kanosje nga neni 181. par.4. lidhur me para. 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 të (KPRK)-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor më datë 23.02.2022, në të cilin i akuzuari Mërgim Isakaj ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Prokurori i shtetit deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit meqenëse të njëjtin pranim të fajësisë sa i përket veprës penale e ka bërë vullnetarisht, që është në pajtim me neni 248. të KPP-së.

E dëmtuara V.K. deklaron: nuk do të parashtroj kërkesë pasurore juridike, të pandehurin e kam djalë, kurrë më pare nuk kemi pasur problem me të njëjtin, incidenti ka ndodhur nga momenti i çastit rrethe mospajtimit ë fjalëve si zeng verbale, jetojmë me një familje, kujdeset për prind, kjo ka qenë hera e pare që kemi pasur mosmarrëveshje, nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe kërkoj nga gjykata që birit tim të i shqiptoj një dënim sa më të butë dhe kërkoj nga i njëjti që në të ardhmen të sillet sa më butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.I. av. A.H. deklaron se: pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit Mërgim Isakaj i propozoj gjykatës ta bëjë pranimin e fajësisë dhe se me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ta vlerësoj si rrethanë posaçërisht lehtësuese këtë pranim të fajësisë, kërkon falje dhe sjelljen para veprës penale ashtu që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të i aplikon dispozitat për zbutjen e dënimit nga nenin 71. dhe 72. të KPRK-së. I pandehuri gjendet nën masën e paraburgimit deri më [datën 26.02.2022, andaj i propozoj gjykatës që sot të njëjtit të i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtin ta liroj.

I akuzuari M.I. deklaron se: e pranon fajësinë vullnetarisht, jam penduar për një veprim të tillë që kam bërë, të dëmtuarën e kam nënë e cila është prezentë në seancë dhe në prezencën e gjyqtarit dhe prokurorit i kërkoj falje, të cilën veprim edhe e bëri në prezencën e gjykatës, theksoj se kjo ka qenë hera e parë dhe e pa qëllim të, premtoj dhe zotohem se kurrë më nuk do të përsërisë veprime të tilla kundërligjore, do të kujdesem edhe më shumë për prindërit e mijë dhe familjen time, jam i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike – materiale , mbajtës i vetëm i familjes, e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata në shqyrtim fillestar gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me datë 26.01.2022, rrethe orës 10:00 në Lagjën në Prizren, saktësisht në banesën e tyre të përbashkët familjare, me qëllim të frikësimit, e kanos seriozisht me fjalë se do ta privojë nga jeta të dëmtuarën V.K. konkretisht nënën e tij – viktimë e ndjeshme, në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje lidhur me kërkesën e tij të vazhdueshme që prindërit ti jepnin para, i pandehuri për një moment pasi e dëmtuara nuk pranoi ti jepte para, në gjendje të nervozuar i drejtohet me ton të lartë se “ unë po du pare, nëse nuk më jep pare atëherë keni me ma pa sherrin, kam me thye gjithçka që ka në banesë “ , e më pas në shenjë revolte ia merr telefonin e të dëmtuarës duke i thënë se do ta shesë dhe largohet nga banesa, me ç ‘rast me këtë veprim tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e saj personale.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale, kanosje nga neni 181. par.4. lidhur me para. 1. të KPRK-së.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 257 të KPRK-së.

Gjithashtu, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248. lidhur me nenin 326. të KPPRK-së, dhe se në veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 181 par.4.lidhur me para.1 i Kodit nr. 06/L-074 të KPRK-së, për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, 71.72 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i premtojë gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore dhe e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë pasi jam i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike-familjare. Po ashtu, gjykata duke pas parasysh se ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit pasi që i akuzuari M.I. e ka pranuar fajësinë dhe është penduar thellë për veprën e kryer penale, në përputhje me nenin 71. dhe 72. të KPK-së, vendosi që ndaj të njëjtit të shqiptoj dënim me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit. Andaj, duke mos gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen të akuzuarin do ta parandalojë nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari, dhe në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla të kundërligjshme.

Gjykata vendimin e vet e ka bazuar edhe në parimet e Konventës së Këshillit të Evropës (Konventën e Stambollit) për parandalim dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e cila synon të parandalojë dhunën, ti mbrojë viktimat dhe ti ndjekë kryesit të këtyre veprave penale me tolerancë zero për këtë lloj dhune.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 463 par. 1. dhe 2. të KPPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u mor në kuptim të nenit 450. dhe 453. par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39. par. 3. pika 1. të Ligjit nr.05/L-036.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2022:016793, 23.02.2022

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.